

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ADRIAT FASHION” Sh.p.k**

**I.        THEMELIMI**

**NENI 1**

**Ortakët themelues**

Shoqeria krijohet nga ortaku themelues:

- Z. Xhemal Burreli, shtetas shqiptar, lindur më 28.02.1959 në Leknas , Tiranë , Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi F90228242P , madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

**II.        EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE – OBJEKTI**

**NENI 2**

**Emërtimi**

Shoqeria emertohet “ADRIAT Fashion” Sh.p.k

**NENI 3**

**Forma juridike**

Forma juridike do te jetë shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 “Per shoqerite Tregtare”.

#### **NENI 4**

##### **Selia**

4.1 Shoqeria “ADRIAT Fashion” Sh.p.k e ka seline e saj ne adresen: Tirane , Kamez , Laknas ,Ruga “Skenderbeu” , Ndertesa nr 172 ,Zona kadastrale nr 2372 , Nr pasurie 180/33.

4.2 Shoqeria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund te kryeje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ose jashtë saj, nepermjet filialeve, degeve, zyrave te perfaqesimit ose agjensite e saj, te cilat jane krijuar me vendim të Asamblesë së Pergjithshme të Shoqerise dhe do te veprojne nen mbikqyrjen e Administratorëve të “ADRIAT Fashion” Sh.p.k.

#### **NENI 5**

##### **Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë**

5.1. Shoqëria “ADRIAT Fashion” Sh.p.k ushtron veprimitarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimitaria e Shoqërisë “ADRIAT Fashion” Sh.p.k, do të ketë për objekt: Punime lekure me dore, çanta, faqe sandalesh, rripa, aksesore te ndryshem me material te porositesit dhe nenkontraktor (Fason). Perpunim dhe prodhim te veshjeve e tekstileve.

5.3 Shoqëria mund te kryeje cdo lloj veprimitarie tjeter që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.4 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimitarisë së saj.

5.5 Objekti i shoqerise mund te ndryshoje, te zgjerohet ose te pakesohet ne baze te vendimit



te Asamblese se Pergjithshme.

### **III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA**

#### **NENI 6**

##### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine per nje periudhe kohore te pacaktuar.

#### **NENI 7**

##### **Kapitali i Shoqerise**

7.1 Kapitali themeltar i shoqerise “ADRIAT Fashion” Sh.p.k perfaqesohet nga 1 (nje) kuote me vlore totale 100,000 (njeqind mij) leke e cila nuk eshte paguar.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise:

– Z. Xhemal Burreli : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te përgjithshme 100,000 (njeqind mij) leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### **NENI 8**

##### **Asambleja e Pergjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Pergjithshme. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet qe ligji apo Statuti ia rezervon ketij organi, si dhe per ceshtjet per te cilat, Administratori kerkon mendimin apo miratimin e Asamblesë se Pergjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë se Pergjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen ne nje regjister te posacem te mbajtur prane selise se Shoqerise “ADRIAT Fashion” Sh.p.k.

8.2 Jane ne kompetencen ekskluzive te Asamblese se Ortakëve marrja e vendimeve per sa i perket:

- ndryshimit te Statutit;
- riorganizimi i shoqerise, ndarja, bashkimi, likujdimi, shnderrimi i shoqerise;

- zmadhimi, zvogelimi i kapitalit, transferimi i pjesave te kapitalit themeltar tek te tretet, si dhe blerjen e pjesave te kapitalit themeltar nga vete shoqeria me qellim anullimin e tyre;
- emerimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emerimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe te gjitha kompetencat e tjera qe ligji dhe/ose Statuti japosin shprehimisht Asamblese

## **NENI 9**

### **Organet drejtuese**

**9.1. Organet drejtuese te Shoqerise janë:**

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë Ortakët e Shoqërisë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

## **NENI 10**

### **Administratori i Shoqërisë**

**10.1** Shoqeria administrohet nga Administratori, person fizik qe mund te jetë ose jo ortak i Shoqërisë.

**10.2** Administratori eshte te detyruar te drejtoje Shoqerinë ne përputhje me ligjin “ Përtregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

**10.3** Administratori i Shoqërisë emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do te qendroje ne detyre per një kohë prej 5 (pese) vjetesh.

**10.4** Administratori e pare te shoqërisë emerohet:

- Z. Xhemal Burreli, shtetas shqiptar, lindur më 28.02.1959 ne Laknas , Tiranë , Shqipëri, identifikuar me nr identifikimi F90228242P, madhor e me zotësi te plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit

Zhemal Burreli *Z. Burreli*

10.5 Administratori ka te gjitha kompetencat qe i njeh ligji dhe Statuti i Shoqerise.

#### NENI 11

#### Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet

11.1 Per sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, reference i behet legjislacionit shqiptar ne fuqi.

11.2. Per te gjitha mosmarreveshjet brenda shoqerise qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi komponent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

11.3. Ky dokument redaktohet ne 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovar e nenshkuar nga ortaku themelues

#### ORTAKET THEMELUES

Z.Xhemal Burreli

Zhemal Burreli *Z. Burreli*

Data: 21/04/2022